



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-4976 /19  
Kaçanik, 27. 02. 2019

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II ( Dytë )** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 27 Shkurt 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale: Zahir Doda, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku dhe Diana Reka; ndërkaq nga zyrtarët ishin : Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua, Farku Dërmaku.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje e konstatoj kuorumin, pjesëmarrës në mbledhje janë të gjithë anëtarët e KK, ndërkaq në vazhdim po e bëjë një, njoftim lidhur me Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të parcelave kadastrale Nr. 00229-2 dhe 00229-4 ZK Doganaj, në pronësi të Naser Guri, që ishte në rend pune si pikë e 8 sipas Ftesës për mbledhje. Unë kërkoj që ky Propozim Vendim të hiqet nga rendi i punës, për shkak se kërkohet dokumentacion me i kompletuar. Propozimin me hequr këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 4 votë Abstenime. Në bazë të rezultatit të votimit, pika e 8 hiqet, ndërkaq pikët tjera 9-12 ç vendosen për një pikë më lartë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit e prezantoj rendin e punës të mbledhjes së II (Dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 27 Shkurt, me 11 pika, si vijon:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2018;
3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2018;
4. Raporti i Auditimit të Brendshëm, për vitin 2018;
5. Raporti Financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2018;

6. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2018, në vitin 2019;
7. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, parcelës kadastrale Nr. 00078-2 ZK Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës së 4 (Katërt) në pronësi të Milaim Dogani;
8. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
9. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019;
10. Propozim Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK, për ndarjen e masës drusore të konfiskuara në vitin 2018; dhe
11. Propozim Vendimin për Lejimin e mjeteve buxhetore për xhirimin e filmit “Ne kërkim të Venerës”.

Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Kërkoj që katet pikët e fundit (8-11) të cilat na kanë ardhur pas afatit të përcaktuar ligjor, të hiqen nga rendi i propozuar i punës. Në vazhdim z. Kyçyku e lexoj nenin 43 pika 3 e LVL, që ka të bëjë me afatin kohor për dërgimin e materialit të mbledhjeve të rregullta të KK, ndërkaq shtoj se, nëse këto pika hynë në rend pune, atëherë ne subjekti politik i LVV kur të shqyrtohen këto katër pika, do ta lëshojmë mbledhjen.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Propozim Vendimin për Lejimin e mjeteve buxhetore për xhirimin e filmit “Ne kërkim të Venerës”, mua me ka ardhur paraprakisht kjo kërkesë. Edhe pse është e arsyeshme kjo çështje, kërkesa ka ardhur me vonesë. Këtu është një kontribut i një aktorit tonë, Arben Zharku, ku është përzgjedhur komuna jonë për me xhiruar atë film, kështu që nuk kemi pasur mundësi me herët me e proceduar. Të pika, Ndryshim Plotësimi i Vendimit për ndarjen e masës drusore, Propozim Vendimi ka qenë me ua ndarë shkollave drutë, ndërkaq nuk ka kaluar ashtu si është propozuar, ndërkaq KK nuk ka pasur mundësi aty për aty me ndryshuar destinimin e tyre, ndërkaq ka pasur mundësi me propozuar me ia ndërruar destinimin, ndërkaq me e shqyrtuar në mbledhjen vijuese. Shkollat e komunës kanë nevojë për dru, ndërkaq vendimi me ua ndarë skamnoreve drutë e konfiskuara të vitit 2018, veç sa krijon probleme, kështu kemi dal me këtë Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës.

**z. Ekrem Kyçyku,** E lexoj pikën 2 të nenit 47 e cila ka të bëjë me çështjen kur mund të hyn në rend pune ndonjë pikë, që është urgjente me rëndësi publike.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkojmë mirëkuptim se nganjëherë po përballemi me çështje të cilat po na adresohen për me i futur në rend pune pas afatit të përcaktuar ligjor. Pikën: Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019, mund të lëmë për mbledhjen vijuese, nëse jeni të pajtimit, megjithëse nuk ka shumë punë ky plan. Pikën: Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet dhe transferet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019, unë kam kërkuar me kohë nga Ekzekutivi i Komunës me i sjellë propozimet, mirëpo drejtori i DAK ka qenë në pushim mjekësor dhe ka kërkuar mirëkuptim për vonesën e kësaj pike, kjo ka qenë arsyeja, ndërkaq nuk është vonuar shumë kjo pikë. Ndërkaq, për dy pikët e fundit, pika 10 dhe pika 11; ne në mbledhjen e KPF në Parim jemi pajtuar që të jenë pikë të rendit të punës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, vonesa ka pasur derisa organet i kanë përgatitur, Propozim Vendimet. Materiali i këtyre dy pikëve nuk është i gjerë, çështja që mund të ngjiteni për to, është për shkak të afateve ligjore. Të çështja e Kërkesës për xhirimin e filmit, “Ne kërkim të Venerës” kjo pikë është

vonuar, për shkak se pala nuk iu ka drejtuar fillimisht organit kompetent, por Kryesuesit të Kuvendit, kështu kjo çështje është proceduar nga ana ime tek organi përkatës. Ekzekutivi i Komunës nuk ka pasur mundësi me iu përgjigjur menjëherë kësaj kërkesë, kjo është arsyeja që jemi vonuar në këtë drejtim. Shuma e kërkuar e mjeteve buxhetore, është 5.000€ për xhirimin e një filmit në komunën tonë dhe atë, ne vendet më të mira të komunës së Kaçanikut. Unë nuk besoj se paraqet problem çështja se a ka ardhur me vonesë apo jo, kjo pikë, por çështja është se, a e kemi disponimin si Kuvend i Komunës me i ndarë ato mjete.

**z. Zahir Doda,** Lidhur me Propozim Vendimin për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet dhe transferet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019, kërkoj mirëkuptim që kanë ardhur me vonesë këto dy pikë, për arsyet të cilat i potencoj Kryesuesi i Kuvendit. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet dhe transferet, kjo çështje ka kaluar edhe procedurën e KPF, aty ka qenë prezentë edhe anëtari i KPF, Ekrem Kyçyku, kështu ky propozim vendim, pasi ka marrë miratimin e KPF, i është adresuar Kuvendit të Komunës. Unë besoj se nuk paraqet problem aq shumë së materiali për këto dy pikë iu është dërguar me vonesë dhe nuk është materiali i gjerë që mos me pasur mundësi me e lexuar.

**z. Ekrem Kyçyku,** Ne në mbledhjen e KPF i kemi përcjellë këto pikë për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, por nuk i kemi votuar në KPF. Ne nuk jemi kundër këtyre pikave, por çështja është zbatimi i procedurave administrative, ashtu siç e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, kështu që, ne subjekti politik i LVV, qëndrojmë pranë kërkesës tonë të cilën e theksuam më herët, së nuk do të qëndrojmë në mbledhje kur të shqyrtohen 4 pikët e fundit.

**z. Ekrem Raka,** Unë pajtohem më vërejtjet të cilat i theksoj shefi i GP nga LVV, Ekrem Kyçyku, për pikat të cilat na kanë arritur pas afatit të përcaktuar ligjore, nga arsyeja së nuk është hera e parë që na adresohen pikë pas afatit të përcaktuar si në LVL. Unë mendoj që, kur Ekzekutivi i Komunës na e dërgon një lëndë pas afatit të përcaktuar ligjor me e futur në rend pune, atëherë duhet me dhënë arsyeshmërinë, pse kjo lëndë është urgjente. Unë, nuk pajtohem me hyrë pikë në rend pune, pas afatit të përcaktuar ligjor.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë sa herë kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës që materiali i mbledhjes t 'na ofrohet me kohë, ndërkaq, ne e pranojmë që disa pika kanë ardhur me vonesë, mirëpo nganjëherë po ka edhe probleme teknike. Të këto pikë për të cilat materiali është dërguar me vonesë, për shkak të natyrës që e kanë, unë kërkoj të shqyrtohen sot në këtë mbledhje.

**z. Selim Reka,** Është e vërtetë ato të cilat i potencoj z. Ekrem Kyçyku, mirëpo ne në mbledhjen e KPF duke e parë arsyeshmërinë e këtyre dy pikave, dy pikave të fundit, në parim në KPF jemi pajtuar me u futur në rend pune në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës, kështu që mbetet të shikojmë kur të dalin në votim rendi i punës, sesi po rrjedh rezultati i votimit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Rendin e propozuar të punës pa pikën e 8, që ishte listuar në ftesën për mbledhje, e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është 21 votë Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV, Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të këtij rezultati të votimit, del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### **APROVOJ**

**Rendin e Punës në përbërje prej 11 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;**

Procesverbali i mbledhjes së 1-r (Parë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa ndonjë vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e ,

**APROVOJ**

**Procesverbalin nga mbledhja e 1-r (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 29 Janar 2019. / Lënda: 01Nr. 60/01-1994/19.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Para se me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave, i kam dy njoftime për anëtarët e Kuvendit të Komunës;

- 1. Për Pagat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës:**
- 2. Deklarimin e pasurisë së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.**

1. Sipas Ligjit për Pagat, e cila na është kërkuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) me ua sqaruar rangimin për Pagat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, sepse, anëtarët e Kuvendeve Komunale të po iu kërkojnë sqarime të nevojshme AKK. Për Pagat, sqarimi është si vijon: Fillimisht poentimi ka qenë, 1.7, ndërkaq MAP ka vendosur të jetë, 1.25, mirëpo ne Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale, kemi pasur kërkesë Komisionit Parlamentarë për Administratë Publike dhe ky komision ka vendosur që poentimi për anëtarë të KK të jetë: 1.7. Sqarimet e tyre janë së: Pagat e anëtarëve të Kuvendeve Komunale, rangohen me poentimin i cili ka kaluar në Kuvendin e Kosovës. 1.7 e që i bien diku, 406€ paga bazë. Mëditja për Mbledhje që është 121€, që i bien 30% e pagës bazë. Paga e një anëtari të Kuvendit i vjen diku, 527 euro e 20 cent për të gjithë ata anëtarë të KK që nuk marrin pagë tjetër nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Kjo pagë nuk vlen për ata që marrin pagë tjetër nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës, por të punësuarit do të marrin pagën bazë ku janë të punësuar dhe 30% të pagës bazë të anëtarit të KK apo shumën 121€. Zbatimi i Ligjit për Pagat, fillon nga muaji tetor i këtij viti.

2. Për Deklarimin e pasurisë, afati ligjor për Deklarim e Rregullt të Pasurisë është 1-31 Mars. Deklarimi i pasurisë është obligim ligjor. Ne kemi kërkuar nga Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale, me u hequr Deklarimi i pasurisë për anëtarët e Kuvendeve Komunale, sepse natyra e tyre e punës, nuk paraqet ndonjë rrezik që me deklaruar pasurinë. Besoj se Ministria përkatëse do të merr veprime të nevojshme për Ndryshim Plotësimin e Ligjit për Deklarimin e Pasurisë. Mirëpo, përderisa Ligji për deklarimin e pasurisë është në fuqi, duhet të kemi parasysh se, duhet të e deklarojmë pasurinë në afatin e përcaktuar ligjor 1-31 Mars, ashtu që t'i plotësoni formularët dhe t'i dërgoni në Agjencinë Kundër Korrupsionit, sepse janë procedurat ndëshkuese për mos deklarim të pasurisë, në afatin e përcaktuar ligjor, ndërkaq duhet ta keni parasysh së deklarimi i pasurisë është obligim personal i secilit anëtar të KK.

## Pyetje dhe Kërkesa

### **z. Shpend Krusha;**

Kërkoj nga DSHPE që të vendosën mbrojtëse të, Ura mbi lumin Neredime në f. Stagovë, sepse nuk ka mbrojtje në atë pjesë. Lidhur me këtë çështje, unë kërkoj me u bërë mbrojtëse e veçantë për këmbësorë dhe mbrojtëse e veçantë për auto vetura.

**z. Adnan Reka,** Kërkojmë që, nga shtëpia e kulturës deri te xhamia e dëshmorëve, të rregullohet ndriçimi publik me shtylla të larta, meqë ndriçimi aktual po thehet vazhdimisht nga vandalistë apo përdorues të drogave. Përmes ndriçimit do të pamundësohet që kjo pjesë e qytetit të bëhet rrugicë e rrezikshme e përdoruesve të narkotikëve.

**z. Ekrem Kyçyku,** Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, në një mbledhje të Kuvendit të Komunës, është zotuar se do të parandaloj arsimtarëve, mbajtjen e orëve plotësuese me nxënës, ndërkaq ka arsimtarë të shkollave që ende mbajnë orë plotësuese, e në veçanti, ata të gjuhës angleze.

### **znj. Kaltrina Tafili,**

1. Rruga “Remzi Zharku” në Kaçanik, është rrugë e ngushtë dhe shumë e vështirë me u lidhë me rrugën tjetër të qytetit. Kërkoj nga drejtoria përkatëse e komunës, me marrë veprime të nevojshme për zgjerimin e asaj rruge si dhe ndriçimin e saj.

2. Në shkollën fillore “Emin Duraku” në Kaçanik- lagja “Dushkajë”, arsimtarët po i lënë nxënësit e shkollës duke mbajtur orë kujdestarie, ndërkaq ata nxënës po pësojnë me humbjen e orëve të tyre të mësimi.

### **znj. Nazife Krasniqi,**

1. Të DSHMS, Unë e kam një Kërkesë, kur dihet se na mungon, Gjinekologu në QKMF, ndërkaq sipas informatave të cilave i kam, është e pamundur me ardhur gjinekolog i rregullt në komunën tonë. Është mirë me gjetur një formë që së paku një herë në javë me ardhur gjinekologu për vizitë, pse jo edhe ndonjë specialist tjetër mjekësor. Mjete buxhetore ka, ashtu që me marrë gjinekolog dhe ndonjë specialist tjetër, me kontratë në vepër.

2. Lidhur me Barnatoret farmaceutike, qytetarët kanë ankesa se nuk ka kujdestari të barnatoreve. Në këtë drejtim duhet me bërë diçka, ashtu që, një barnatore farmaceutike sa herë me qenë në kujdestari.

**znj. Hafize Sallahi,** Rruga që lidhë varrezat e qytetit dhe f. Stagovë, aty është bërë shembja e dheut, kështu me pasur mundësi me pastruar dhe më bërë një muri mbrojtës në atë pjesë kishte qenë mirë. Në atë pjesë janë hedhur edhe mbeturina, përfshirë edhe ato të ngurta.

### **z. Bekim Koxha,**

1. Përse nuk po merren veprime të nevojshme nga organet përkatëse të komunë, ashtu që anëtarët e Kuvendit të Komunës, të pajisemi me kartela identifikuese,

2. Kërkoj informacione të nevojshme nga DUKMM, se a është lëshuar, Leja e ndërtimit nga ky organ për objektin e ETC-së që është duke u ndërtuar në qytet dhe Leja e ndërtimit për objektin të “Shelja” në qytetin e Kaçanikut.

**znj. Afërdita Shehi,** Me intereson të di, a ka mjete buxhetore të destinuara për ndërtimin e rrugës alternative në relacionin, Biçec-Kovaqec ?

**Kryesuesi i Kuvendit,** Lidhur me Kërkesën e z. Bekim Koxha, për çështjen e pajisjes së anëtarëve të KK, me këtë punë do të merrem unë, ndërkaq kërkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të KK.

## 2. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush di\ka në këtë Raport e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Raportin e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Me të cilin e Aprovoj, Raportin e Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 060/01-4631/19.**

## 3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ky Raport pune është hartuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, raporti nuk do të votohet, por me tepër është sa për informacionin tuaj lidhur me aktivitetin e zhvilluar të komunës tonë. Prezentë në mbledhje është, Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, për sqarime të nevojshme. Nëse ka të interesuar me marrë fjalën në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka,** Kaosi urban veç ka filluar të shfaqet p.sh. (djegia e shtëpive dhe deponitë ilegale të mbeturinave nëpër lagje). Të gjitha ndërtesat e larta që po ndërtohen çdo dite sipas planeve rregulluese, duhet të kenë parkingje, të respektohet vija vektoriale, të ruhet distancat në mes të ndërtesave dhe rrugëve, inspektimi të jetë i vazhdueshëm gjatë procesit të ndërtimit si dhe masat e sigurisë në punë, kriteret këto që aspak nuk përfillen për të evituar kaosin urban. A duhet dikush të bëjë pranimin teknik të këtyre objekteve? Projekti kryesor i urës mbi lumin Lepenc në fshatin Kovaceq - kur ka përfunduar ? Edhe kur nuk keni të drejtë ligjore në ndërrimin e destinimit të tokës së kategorisë I- 4 ju vazhdoni ta bëni një gjë të tillë që për ne vazhdon të jetë kundërligjore. Të DFSHPE, Infrastruktura rrugore- Asfaltime të rrugëve lokale, unë përsëri dua të ju rikujtoj se 1/3 e popullsisë jeton në zonën I dhe II, ndërsa kur vjen puna të investimet apo të infrastruktura rrugore, ju përsëri jeni shumë të padrejtë. E di që janë investime nga buxheti komunal, investime nga ministri të ndryshme, veç a e dini sa është shuma, nga 1,195,435 € sa janë investuar gjatë vitit 2017 / 2018 dhe 2019, a e dini sa janë investuar në zonën I dhe II vetëm 165,425 €, 1,030,010€ janë investuar kryesisht në zonën III, kjo nuk ka lidhje as me 1/8 e popullsisë, raportet janë shumë diskriminuese. A e dini se në rrugën 'Avdurrahim Shehu' nuk ka mundësi të kalojnë dy vetura përballë njëra tjetrës, dhe çfarë katastrofe mundet me ndodhë, duke e pasur parasysh dendësinë e popullsisë së asaj lagje të zonës I, mos harroni se banorët e lagjes 'Idriz Seferi' janë taksapagues të zonës së I. Cilat janë kriteret që një rrugë mund të përfitoj investime. Të ujësjellësi, A ka mundësi me ditur, sa para janë investuar në ujësjellës në Zonë I dhe II, përveç rezervarit 1000 m<sup>3</sup> që e ka ndërtuar B&E por që qytetarët prapëseprapë nuk po kanë ujë të pijshëm. Sistemin e ujësjellësit po e shtrini me mburrje, por nuk po e qani kokën t'i ndërroni gypat e asbestit si dhe t'i rrisni kapacitetin e gypave që të furnizoni të gjithë qytetarët me ujë pa dallim. Të kanalizimet, si është e mundur të

shpenzoni mbi 400.000 € në kanalizim dhe qendra urbane të notoj nga ujërat atmosferik dhe kanalizimet, ndërkaq sa herë të arsyetoheni duke përsëritur frazën e njëjtë që nga viti 2016 se vitin e ardhshëm, do të rregullohen te gjitha rrugët dhe kanalizimet e zonës urbane.

Të ujërat sipërfaqësore – Përrojet; Nuk mund të mos ua përkujtoj, 'Përroin e Rakocit'. Si guxojnë zyrtarët e lartë komunal t'ju thonë qytetarëve 'ani pse skamnorë' dil ndërto shtëpi pa leje mbi digën e përroit të Rakocit, ajo digë është mbrojtje për të gjithë qytetin, ata që e kanë projektuar dhe ndërtuar, ose paskan qenë larg më profesionistë se ju, ose e paskan dashur shumë më tepër se ju këtë qytet. Po të pastrohej ajo digë, do ta ndalte rrëën, gurët, dhe do të kontrollonte sasinë e ujit që mund të përballojë shtrati i përroit dhe lumi Nerodime, dhe në këtë mënyrë do të evitoheshin përmbytjet e qytetit të cilat i pamë në këtë kohë vitin e kaluar. Menaxhimi i mbeturinave, a keni shifra, sa deponi ilegale janë të regjistruara zyrtarisht? Janë 22 gjithsej, e që jam i sigurt që ka shumë më tepër jo zyrtarisht dhe po na e nxijnë imazhin për çdo ditë. Sa mbeturina inerte organike dhe inorganike ka, "Guri i Zi" me tonelata, që kurrë nuk mendoj se do të hiqen. Ky vend është burim permanent i epidemive të ndryshme, dhe është bërë si akusheri e qenve endacak, që pastaj duhet të ndajmë para nga ky buxhet për t'i trajtuar qentë sepse janë të rrezikshëm edhe bartin sëmundje, në vend se të ndajmë para për t'i trajtuar mbeturinat tani. Duhet ta pranoni se gjendja është alarmante nga mbeturinat në këtë Zonë të qytetit. Sa gjoba janë shqiptuar për hedhje të mbeturinave? Të Komunikacioni rrugor, për mua është kaos. Sigurisht i dini rastet e djegies së shtëpive nga pamundësia e depërtimit të zjarrfikësve nga parkingjet ilegale nëpër lagje dhe pamundësinë e depërtimit të kamionit të mbeturinave, dhe si pasoj kemi edhe deponi ilegale të mbeturinave nëpër lagje. Sa ndërtesa kanë parkingje, pastaj nënkalinimin hekurudhorë për te shkolla në 'Dushkajë' ku rrezikohen mbi 1000 nxënës nga treni për çdo ditë, nuk jeni në gjendje ta bëni para se të ndodhë ndonjë fatkeqësi, sepse dikur do të jetë vonë. Hapësirat publike- Gjelbërimi dhe Parqet: Ekzekutivi i Komunës çdo herë ankohet se nuk ka hapësira publike, sepse hapësirat publike ua jep kompanive private, ndërsa shërbimet publike i vendosë në toka private, për t'iu paguar qira. Të Parqet, unë nuk e di që komuna jonë ka ndonjë park. Hapësirat të gjelbër nuk mund të jenë të fragmentuara para ndërtesave private apo në thellësi të lagjeve, sa për ta arsyetuar një obligim ligjorë që ka komuna ndaj institucioneve qendrore. Ato duhet të jenë një obligim i ndërtueseve të cilët komuna duhet t'i monitorojë dhe detyrojë. Ku mbetën drunjtë dekorative përgjatë lumit Nerodime, nga ura e Hazirit deri te xhamia e dëshmorëve, paguar nga buxheti por që nuk janë aty. (Gati 32.000 euro, kot) Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave, Rregullimi i varrezave faza III, 4,952€, për një kanal të mbushur me zhavorr 5000 € ndërsa kufomat ende fundosen në ujë, s'kam koment! Trotualet dhe urat: Projektet, Zgjerimi i Urës së Hazirit dhe Urës në rr. "Vëllezërit Çaka", 45.371 €, ndërsa komplet Ura në Runjevë kushton 30.126 €, paradoks, ky është dyshim për keqpërdorim të buxhetit Të menaxhimi i emergjencave, në këtë kohë vitin e kaluar, nuk na keni bindur se jeni të aftë të menaxhoni gjendjet e jashtëzakonshme eventuale, u dashtë më shumë se dy javë ditë për ta hapur arterien kryesore të qytetit. A ka komuna ndonjë fond për emergjenca?, ndërkaq në anën tjetër, paguan gati gjysmë milion euro penallti të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkoj të respektohet minutazha e diskutimit, ashtu si është e përcaktuar në rregulloren për Punë të KK.

**z. Ekrem Kyçyku,** Në Raport më tepër janë përmendur planet organit ekzekutiv të komunës, sesa është potencuar për realizimin e tyre. Ne duhet me ditur, a është Plan apo Raport ky material. Në këtë Raport, nuk është potencuar prioritetet e Sektorit të, Sportit, Kulturës dhe Rinisë. Komuna në këtë drejtim, duhet kordinoj aktivitetet me Ministrinë e Kulturës për realizim të projekteve të këtij sektori, në mënyrë që mos të ngelin prapa në këtë

sektor. Të prioritete; ka projekte të cilat është dashur të realizohen me Investimi i qeverisë në bashkëfinancim me qeveritë, ndërkaq nuk janë realizuar ende. Halla Sportive nuk është përfunduar ende. Të inspektoriatit, nga raporti shihet se vetëm ka 4 gjoba të shqiptuara, ndërkaq një gjobë i është bërë një shokut tim, pais kemi bërë zhurmë në KPF, ndërkaq i kanë thënë se nuk të kishim dënuar, por po bëjnë zhurmë ata të LVV. Nuk është më rëndësi shumë se kujt iu ka shqiptuar gjoba, por më rëndësi është që vetëm 4 gjoba të shqiptuara për gjatë një 1 viti buxhetor, kujtoj se janë shumë pak.

Nga Raporti shihet se janë marrë 4 mostra të ujit, ndërkaq nuk jepen sesi kanë dalë rezultatet. Të subvencionet; Në sektorin e Bujqësisë, është mirë që janë subvencionuar bujqit, mirëpo duhet bërë ende në këtë drejtim. Është mirë në të ardhmën të subvencionohen zeqet. Të konfiskimi i masës drusore, sasia është e vogël vetëm 54.81m<sup>3</sup> dru, ndërkaq pyjet e komunës po dëmtohen më të madhe.

**z. Selim Reka,** Çështja e Inspektoratit- ky sektor, nuk ka treguar rezultate në asnjë nga fushat e përcaktuara. Çështje tjetër që shqetësuese është, menaxhimi i dobët i projekteve, pastaj, heqja dorë e një numrit të madh të qytetarëve të komunës nga nënshtetësia. Lidhur me heqjen dorë të një numri të konsiderueshëm nga nënshtetësia e Kosovës, nuk është bërë ndonjë analizë, pse po ndodhë kjo. Tjetër, kushtet të cilat po punon, Sektori i Arkivit të Komunës, kujtoj se nuk janë aspak të mira. Në këtë drejtim, duhet me bërë një zgjidhje për ruajtjen e lëndëve në arkivë në formë fizike dhe për ruajtjen e lëndëve arkivore edhe në formë elektronike.

**z. Besim Vishi,** Sqaroj për rreziqet që mund të ndodhin ose që kanë ndodhë në të kaluarën, pasoja të rënda me vdekje ose edhe dëme materiale gjatë punimeve në shtëpi private e edhe objekte banesore, ku gjatë dhënies së lejeve ndërtimore nga drejtoria përkatëse nuk iu është kërkuar asnjëherë palëve edhe leja për Pëlqim parimor paraprak nga ana e KEDS-it, sepse shpesh janë bërë ndërtime edhe mbi kablllo elektrike nëntokësore por edhe nën përçues elektrik ajror, e që nuk lejohet pa një zgjidhje teknike nga KEDS-i për arsye që thash më lart kanë ndodhur pasoja!?, Ju këshilloj që para dhënies së lejeve ndërtimore nga drejtoria komunale, paraprakisht palës t'i kërkohej së pari Leja për Pëlqim parimor nga KEDS-i, e që është një preventivë për mos pasoja në të ardhmen. Këtë shqetësim e di se e ka ngritur disa herë edhe znj. Nazife, sepse i rrezikohet shtëpia nga ndërtimet e larta aty. Aty ku e ka potencuar problemin znj. Nazife, duhet të vendoset një orman, sepse ka mundësi me u rrezikuar shtëpitë e banimit.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Ky është raport i Ekzekutivit të Komunës, nuk do më thënë që është i përkryer, por janë bërë edhe punë të mira për gjatë një viti. Të çështja e prioriteteve, fshat-qytet, unë i jap rëndësi projekteve sipas nevojave. Të shembjet e dheut, të rruga" Idriz Seferi" unë sa herë kam marrë edhe opinione si me dalë nga kjo situatë. Të Halla Sportive, që u përmenden, komunat; Shtimja dhe Kamenica, këto dy komuna, hallën sportive e kanë nisur herët, realizimi i këtyre projekteve ka filluar me tepër se 10 vite. Të çështja e heqjes dorë nga nënshtetësia e qytetarëve të komunës tonë, është edhe shqetësim edhe i yni ky fakt, mirëpo në anën tjetër, nuk mund edhe t'i ndalim. Kryetari në vazhdim dha edhe sqarime të tjera të cilat u ngritën, në lidhje me aktivitetin e komunës për vitin 2018.

**z. Adnan Reka,** Ku prisni me iu lavdëruar në si opozitë, ku ju po e lavdëroni vetën. Unë nuk e përmenda çështjen fshat-qytet, por zonën 1 dhe 2, ashtu që qysh iu mblidhet tatimi qytetarëve, me iu kthyer në projekte, sepse raporti i kthimit në projekte është 1/10 e jo 1/3 sa duhet të jetë. Të emergjenca, është diçka që duhet me u rregulluar. Nëse artierja të mbetet 2 javë pa u kryer, atëherë kjo të bënë me kuptuar se është menaxhim jo i mirë.

**Kryetari i Komunës,** Po ua sqaroj se të gjitha projektet kryesore të komunës janë të pëqendruara në qytet, si; Halla Sportive, QKMF, rrugët, ndriçimi publik, ndërkaq kanalizimi në qytet ka ende defekte, ndërkaq mbetet në të ardhmën të punojmë ende në çshtjen e rrjeteve të kanalizimeve në qytet etj.

**z. Adnan Reka,** Ata që po i përmendni kryetari, janë prona që i shfytëzojnë jo vetëm banorët që jetojnë në Kaçanik, të gjithë qytetarët e komunës, ndërkaq ka vende ku ia ndërtoni rrugën komunitetit, pa pasur asnjë shtëpi banimi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti nuk votohet, kështu konstatohet se,

**Kuvendi i Komunës, u Informua me Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 104/02-4577/19.**

#### 4. Raporti i Auditimit të Brendshëm, për vitin 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti është proceduar për shkak të vërejtje të cilat i kemi pasur nga niveli qendror, ku kemi humbur pikë në grantin e përformancës, kjo është arsyeja që për herë të parë Kuvendi i Komunës po njoftohet me Raporti i Auditimit të Brendshëm, për vitin 2018. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Njësia e Auditimit të Brendshëm ka pasur disa vërejtje Nga Rekomandimet të cilat i ka bërë Zyra e Auditorit, janë në 5 shërbime në të cilat ka bërë auditim, 20 % e rekomandimeve nga raporti shihet së nuk janë zbatuar. Kjo të bënë me kuptuar së zbatimi i rekomandimeve është i vogël në Komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet së,

**Kuvendi i Komunës u Njoftua me Raportin e Auditimit të Brendshëm të Komunës, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 470/03-4574/19.**

#### 5. Raporti Financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Raporti 6 mujor ka qenë më i mirë dhe më i kuptueshëm. Brengosëse është arsyetimi, ku thuhet së nuk ka buxhet për realizimin e projekteve, ndërkaq në anën tjetër realizimi i buxhetit nuk është i mjaftueshëm, kur dihet se 57 mijë euro nuk janë shpenzuar nga Granti Qeveritar, ndërkaq të HVK janë 200.000€. Të inkasimi, shihet së janë 119.000€ të painkasuara, pastaj, mos alokimi i mjeteve buxhetore të huamarrja, kjo të bënë me kuptuar për një menaxhim jo të mirëfillt. Tjetër, Raportit i mungon tabela e subvencioneve dhe transfereve. Të HVK janë 0 (zero) nga Inspektoriati si dhe 0 (zero) të hyra nga Taksat për shfytëzimin e resurseve natyrore. Të ekzekutimi i mjeteve buxhetore, është përzier mbiemri Elife Murseli me Basri Kodrën, duhet të jetë, Elife Murseli e jo Elife Kodra.

**z. Adnan Reka,** Vazhdon të jetë shqetësues fakti se Komuna jonë prinë në Region dhe në Kosovë për shpërndarje jo të mirë të buxhetit, duke shpenzuar shumicën e buxhetit për paga dhe mëdijtje në vend se ta shpenzojë për investime kapitale dhe subvencione. Sipas një raporti të KIPRED (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave). Kaçaniku 7.7 mil. 65% P&M, 21% IK, Shtime 6.8 mil. 61% P&M 25% IK, Shtërpca 3.7 mil. 57% P&M, 30% IK), Ferizaj 29.2 mil. 52% P&M, 32% IK, ndërkaq Hani i Elezit 2.8 mil. 52% P&M, 36% IK,

**z. Ekrem Raka,** Ne sot po debatojmë për një buxhet të cilin e ka miratuar përbërja e kaluar e KK. Ajo të cilën e kam vërejtur nga Raporti financiar, është të, Programi buxhetor, Mallra dhe Shërbime, të pozicioni ku është bërë krahasimi i shpenzimeve buxhetore të vitit 2018 me vitin 2017 shihet se shpenzimet buxhetore në këtë program buxhetor në vitin 2018 shënojnë rritje për 67.63%.

**z. Bahri Selimi,** Struktura e buxhetit ka pësuar ndryshime, sepse është rritur buxheti. Mirëmbajtja e rrugëve në sezonin dimëror është intervenuar në krijimin e kushteve të qytetarëve të komunës, pajisje kompjuterike etj. Një donacion të cilin e kemi fituar nga ministria, mjetet kryesisht kanë shkuar të DAK për pajisjen e laboratorëve. Krejt rritjet buxhetore janë krahas rritjes së buxhetit. Furnizimi me material të SHMP ka pasur ngritje për shkak të pajisjeve të kabineteve. Janë pajisur kabinetet; Biologjisë, Fizikës. Ngritje tjetër, është; Furnizimi i kompanisë “Pastrëtia” me shporta të mbeturinave. Pastaj blerja e agregatëve në disa shkolla dhe në komunë. Kursimet janë të, drekat zyrtare. Drekat janë shtruar për; donatorë, mysafirë etj. Sivjet mendojmë me i ndihmuar me subvencione edhe bizneset në bashkëpunim me një kompani. Shpenzime kemi pasur të Gjykatave, për kontestet. Të Basri Kodra, është bërë një gabim teknik, duhet të jetë, Elife Murseli, ndërkaq është shënuar Kodra. Në vazhdim drejtori dha edhe sqarime të tjera cilat u ngritën në raportin financiar.

**z. Bekim Koxha,** Çka është në pyetje, çështja e Elife Murselit dhe e Basri Kodrës. Përse nuk kthehet Elife Murseli në punë, pasi që vendimi është marrë.

**Kryetari i Komunës,** Lidhur me këtë pyetje, nuk kam ndonjë sqarim!

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti Financiar ishte sa për informimin tuaj, kështu Konstatohet se;

**Kuvendi i Komunës u Njoftua me Raporti Financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2018 / Lënda: 01Nr. 400/01-4854/19.**

**6. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2018, në vitin 2019;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Shpend Krusha,** Vlera e mjeteve të pashpenzuara, kujtoj se është e madhe, kjo të bënë me nënkuptuar për keqmenaxhim të buxhetit të komunës. Nëse po dihet vlera e mjeteve buxhetore, të cilat kanë mundësi të mbesin pa shpenzuar, artëherë pse nuk merrni veprime të nevojshme me herët me i shpenzuar. Është logjike të ngelin mjete buxhetore të emergjencat, ndërkaq të mbesin mjete buxhetore nga programet tjera buxhetore, kur dihet fakti se komuna jonë ka nevoja të shumëta ku mund t'i shpenzoj mjetet buxhetore, e jo të ngelin mjete buxhetore të pashpenzuara. Gati në çdo vit, shihet se po mbesin më shumë se 200.000€,

mjete buxhetore të pashpenzuara, të cilat bartën në vitin vijues. Kjo të bënë me kuptuar për një planifikim apo menaxhim jo të mirë të buxhetit të komunës.

**Kryetari i Komunës,** Të të HVK është problem me planifikuar diçka pa pasur mjetet, sepse dihet se një pjesë dërmuese e tyre mblihdën në muajt e fundit, Nëntor dhe Dhjetor. Këto mjete buxhetore barten e nuk shkojnë në qeveri. Këto mjete ridestinohen për nevoja të komunës.

**z. Shpend Krusha,** Nuk jemi mos me bërë ridestinim të mjeteve të mbetura buxhetore, por çështja është së, kjo praktikë po na përcjellë në vazhdimësi në çdo vit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 19 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 7 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2018 në vitin buxhetor 2019 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-4632/19.**

7. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, parcelës kadastrale Nr. 00078-2 ZK Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës së 4 (Katërt) në pronësi të Milaim Dogani;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e kani marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha,** Më intereson të di, ku është ajo parcelë që kërkohet me iu ndërruar destinimi, a i ploëson kushtet me iu ndërruar destinimi dhe çka ka me u ndërtua në atë parcelë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Prona është në afërsi të “Liburna”, ndërkaq ky është vendim paraprak, për çështjen e lejimit të ndërrimit të destinimit, vendosë MBPZHR se a i ploëtëson kushtet apo jo.

**z. Ukshin Qallaku,** Pasi nuk është me PZHK, ne si drejtori, kemi marrë veprimet në bazë të kërkesës së palës me lejuar ndërrimin e destinimit të pronës në fjalë. Fillimisht duhet të merret vendim paraprak nga Kuvendi i Komunës dhe i njëjti shkon në MBPZHR, ndërkaq nëse Ministria (MBPZHR) e jep Pëlqimin, atëherë vendimin përfundimtar e merr Kuvendi i Komunës, d.m.th. lënda vjen përsëri në KK, për marrjen e vendimit përfundimtar.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 6 anëtarë, Abstenim nuk pati, ndërkaq anëtarë, Hajredin Luta nuk ishte prezent kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM PARAPRAK

**Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, parcelës kadastrale Nr. 00078-2 ZK Kaçanik, me kulturë, Livadh i klasës së 4 (Katërt) në pronësi të Milaim Dogani /Lënda: 01Nr. 06-351/02-36277/18.**

Para se me kaluar në pikën e 8-të, të gjithë anëtarët nga LVV e lëshuan mbledhjen, për shkak se materiali për këto pikë është dërguar me vonesë. Pikët, 8-11 në mbledhje janë prezentë 22 anëtarë.

**8. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka në këtë Plan Pune, e hapi diskutimin: Meqë nuk ka kush diçka për diskutim, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u, aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Me të cilin e Aprovoj Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-5181/19.**

**9. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019;**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Ndarja e mjeteve buxhetore nga programi buxhetor i subvencioneve dhe transfereve, bëhet me Thirrje publike, sipas Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjti u aprovua njëzëri nga anëtarët që ishin prezentë. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për lejimin e mjeteve buxhetore nga subvencionet, për realizimin e projekteve të DAK për vitin 2019, dhe atë; 50,040.00€ për aktivitete arsimore dhe 57,000.00€ për aktivitete kulturore Lënda: 01Nr. 400/01-5157/19.**

**10. Propozim Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK, për ndarjen e masës drusore të konfiskuara në vitin 2018.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Propozim Vendimi është hartuar nga Kryetari i Komunës, për me ndryshuar dhe plotësuar Vendimin e KK, ashtu që, drutë e konfiskuara të cilat kemi vendosur me ua ndarë familjeve skamnore, me ua ndarë shkollave të komunës, për shkak se vendimi nuk ka mundësi me u zbatuar për destinimin e përcaktuar. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka**, Ne LDK-a, kur kur u miratua Vendimi i KK për ndarjen e masës drusore, kemi qenë për me ua ndarë shkollave të komunës. Me vjen mirë që kjo masë drusore e konfiskua, më në fund, po iu ndahet shkollave të komunës, sepse shkollat kanë nevojë për lëndë djegëse-dru.

**z. Bekim Koxha**, Ne më herët në KK e kemi kundërshtuar Propozim Vendimin me ua ndarë drutë e konfiskuar shkollave të komunës, ndërkaq shkollat dihet se kanë nevojë për lëndë djegëse- dru.

**z. Ekrem Raka**, Kryesues, ndoshta fillimisht duhet me e shfuqizuar Vendimin paraprak të KK, sipas të cilit është vendosur që drutë e konfiskuara me ua ndarë familjeve skamnore, pastaj me marrë vendimin e ri, që drutë e konfiskuar me ua ndarë shkollave të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Vendimin e KK, mundemi me ndryshuar dhe plotësuar, apo me shfuqizuar dhe me marrë vendimi të ri. Atëherë, nëse nuk ka kush diçka, këtë çështje e shtroj në votim për aprovim për ndryshim plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e masës drusore të konfiskuar dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, mori këtë:

#### VENDIM

**Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK, 01Nr. 08-322/01-39890/18 të datës 27 Dhjetor 2018 -për ndarjen e masës drusore të konfiskuara në vitin 2018, ashtu që me këtë Vendim, drutë e konfiskuara të vitit 2018, iu ndahen shkollave të komunës/ Lënda: 01Nr. 322/01-5692/19.**

**11. Propozim Vendimin për Lejimin e mjeteve buxhetore për xhirimin e filmit “ Ne kërkim të Venerës”.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka**, Unë e mbështeti çdo çështje që ka të bëjë me kulturë, sepse kjo është forma me e mirë me u përmirësuar imazhi i komunës tonë.

**z. Ekrem Raka**, Filmi “Në kërkim të Venerës” do të realizohet nga njerëz profesional, kështu që, unë jam për lejimin e mjeteve buxhetore për mbështetje të këtij projekti.

**znj. Lirije Luta**, Shtylla qenësore e njerëzimit konsiderohet shkolla, të rinjtë dhe demokracia. E themi këtë, për arsye së, ne si anëtarë të KK dhe si komunë e kemi për obligim qoftë moral dhe financiar t'i përkrahim të rinjtë tanë. Në bazë të informatave të cilave i kam, xhirimi i filmit i cili do të bëhet në komunë tonë, do të jenë pjesëmarrës, nxënës të shkollave të komunës tonë. Ndihej e lumtur, për shkak së përmes nxitjes, nxënësit i jepet mbështetje, me çka krijojnë tek ata vetëbesim ndërkaq vetëbesimi i inkurajon. Përpos gjitha këtyre vlerave pozitive, mendoj se do të ndikoj pozitivisht në etiketimet që i janë bërë Komunës së Kaçanikut. Kjo është një formë e mirë ia heqim imazhin e keq të krijuar Komunës së Kaçanikut.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për lejimin e mjeteve buxhetore në shumë 3,000.00 ( tremijë euro) nga Programi, Subvencioneve dhe Tranfereve të DAK, sektori i Kulturës për, Xhirimin e filmit të metrazhit të gjatë, “ Në kërkim të Venerës”/ Lënda: 01Nr. 060/03-4584/19.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:47, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 22 anëtarë të KK, ndërkaq 5 anëtarët e KK nga LVV nuk ishin prezent për pikët, 8-11.

Procesmbajtës  
Makfiro Malsiu  
5449184



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);**

**nga Mbledhja e II (Dytë ) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019, mbajtur me 27 Shkurt 2019.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....,
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 27. 03. 2019

**Për: Anëtarët e Kuvendit:** z. Shpend Krusha ,  
z. Adnan Reka,  
znj. Hafize Sallahi,  
znj. Kaltrina Tafili,  
znj. Afërdita Shehi

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 27. 02. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

#### **z. Shpend Krusha;**

Kërkoj nga DSHPE që të vendosën mbrojtëse të, Ura mbi lumin Neredime në f. Stagovë, sepse nuk ka mbrojtje në atë pjesë. Lidhur me këtë çështje, unë kërkoj me u bërë mbrojtëse e veçantë për këmbësorë dhe mbrojtëse e veçantë për auto vetura.

- *Ura mbi lumin Nerodime në fshatin Stagovë jemi në dijeni se ka të dëmtuar parmakët e saj. Ne do të analizojmë koston financiare për vendosja e parmakëve, mundësinë e zgjerimit të saj me shtegun për lëvizjen e këmbësorëve dhe do të shqyrtojmë mundësitë për realizimin e këtij projekti.*

**z. Adnan Reka,** Kërkojmë që, nga shtëpia e kulturës deri te xhamia e dëshmorëve, të rregullohet ndriçimi publik me shtylla të larta, meqë ndriçimi aktual po thehet vazhdimisht nga vandalistë apo përdorues të drogave. Përmes ndriçimit do të pamundësohet që kjo pjesë e qytetit të bëhet rrugicë e rrezikshme e përdoruesve të narkotikëve.

- *Drejtoria e shërbimeve publike gjatë tërë vitit përmes kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e ndriçimit publik angazhohet për rregullimin dhe riparimin e dëmtimeve që paraqiten në rrjetin e ndriçimit publik të shkaktuara nga problemet teknike apo edhe të dëmtimeve nga veprimet vandaliste. Kjo gjë është duke ndodhur edhe në rrjetin e ndriçimit publik rreth lumit Nerodime, ku në vazhdimësi kemi dëmtime të llampave ndriçuese. Rreth mundësisë së ndërrimit apo zëvendësimit të tij me shtylla më të larta, kjo do të analizohet nga aspekti i arsyeshmërisë financiare .*

**znj. Kaltrina Tafili,**

Rruga "Remzi Zharku" në Kaçanik, është rrugë e ngushtë dhe shumë e vështirë me u lidhë me rrugën tjetër të qytetit. Kërkoj nga drejtoria përkatëse e komunës, me marrë veprime të nevojshme për zgjerimin e asaj rruge si dhe ndriçimin e saj.

- *Rruga "Remzi Zharku"-Dushkajë, aktualisht është e asfaltuar brenda gjërësisë së saj ekzistuese. Rregullimi i një shiriti ndihmës për kyqe në rrugën magjistrale është në kompetencat e Ministrisë së Infrastrukturës. Kërkesa të kësaj natyre ne kemi adresuar në këtë ministri edhe për kyqjet në rrugën e fshatit Gajre, Bob dhe Nikaj (punim i shiritit ndihmës), por akoma nuk kemi marrë ndonjë përgjigje.*

**znj. Hafize Sallahi,** Rruga që lidhë varrezat e qytetit dhe f. Stagovë, aty është bërë shembja e dheut, kështu me pasur mundësi me pastruar dhe më bërë një muri mbrojtës në atë pjesë kishte qenë mirë. Në atë pjesë janë hedhur edhe mbeturina, përfshirë edhe ato të ngurta.

- *Kompania e kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale ka intervenuar në pastrimin e rrëshqitjeve të dheut në rrugën "Dëshmorët e kombit"/Dushkajë-Stagovë. Në këtë segment rrugor po hudhen mbeturina dhe materiale të ndryshme të ngurta nga demolimet e objekteve ndërtimore, ku me këtë rast edhe po dëmtohet mjedisi jetësor. Janë bërë evidentimet e këtyre deponive ilegale të cilat do të përpiqemi t'i largojmë me raelizimin e projektit "Largimi i deponive ilegale"-projekt në kuadër të DUKMM-së.*

**znj. Afërdita Shehi,** Me intereson të di, a ka mjete buxhetore të destinuara për ndërtimin e rrugës alternative në relacionin, Biçec-Kovaqec ?

- *Në ndarjet buxhetore të vitit 2019, në linjën buxhetore Investime kapitale janë të ndara 30,000.00€ për projektin "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biqec". Investimi i tyre do të bëhet bazuar në prioritetet e evidentuara në këtë lokalitet në bashkëpunim me këshillin e këtij fshati.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

  
Ramadush Osmani  
Drejtore i DSHPE-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

**Përgjigje në pyetjen e Z.Bekim Koxha**

**Pyetja: A është lëshuar leje ndërtimore për ndërtimin e objektit të ETC- së dhe për ndërtimin e objektit të “Shelnja” ?**

**Përgjigjja: Z.Bekim Koxha , ju informojë se që të dy objektet janë të pajisura me leje ndërtimore.**

Drejtori i DUKMM-së  
Ukshin Çallaku



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

### Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Për :**Kemal Murseli**, Kryesues I Kuvendit të Komunës  
Anëtares së Kuvendit **Nazife Krasniqi**

Lënda: përgjigje

Të nderuar

Përmes kësaj shkrese më lejoni që të ju përgjigjem pyetjeve dhe të jap sqarime më të hollësishme rreth kërkesave tuaj, parashtruar në mbledhjen e Kuvendit Komunal Kaçanik. Sa i përket pyetjes së parë ne për herë të dytë hapim konkursin për gjinekolog por nuk ka aplikuar askush, kurse forma tjera nuk kemi pas mundësi pasi që vijat buxhetore dhe ligjore janë të kufizuara.

Kurse për pyetjen e dytë deshta të informoj se ne si drejtori kemi për obligim të ju hartojmë orarin e barnatoreve edhe jemi duke hartuar çdo muaj që të mbahet kujdestaria e për inspektim ne nuk jemi kompetent është inspektori i tregut që ka për detyrë të inspektoj se a zbatohet ai orar që e kemi përcjell tek të gjitha barnatoret QKMF-së dhe Policisë.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

Me respekt

DSHMS  
**Diana Reka**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

**Përgjigje në pyetjen e z. Ekrem Kyqyku:** A është në dijeni Drejtori i Arsimit për kurset jashtë shkolle që po i organizojnë mësimdhënësit?

Unë nuk jam në dijeni që nxënësit kushtëzohen për ndjekjen e kurseve nga ndonjë mësimdhënëës. Nëse hasim në ndonjë rast atëherë do të veprohet sipas Rregullores nr. 02/2018 për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, Neni 47 pika 47.9.

**Përgjigje në pyetjen e znj. Kaltrina Tafili:** A është në dijeni Drejtori i Arsimit se në SHFMU "Emin Duraku" nxënësit angazhohen si kujdestar (roje) te porta e shkollës.

Nuk jam në dijeni për këtë formë të angazhimit të nxënësve, por nëse Këshilli Drejtues i shkollës (që në këtë shkollë e di që është funksional) ka vendosur ashtu, atëherë ajo i takon organizimit të brendshëm dhe ska asgjë shqetësuese. Deri tash nuk kam pasur vërejtje nga prindërit apo ndokush tjetër.



DAK  
Drejtori, Z. Doda